**Tabelë Përputhshmërie**

<table>
<tr><td colspan="2">Direktiva 2004/38/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 29 Prill 2004 “Mbi të drejtën e shtetasve të Bashkimit dhe të anëtarëve të familjeve të tyre për të lëvizur dhe qëndruar lirisht brenda territorit të Shteteve Anëtare”, që ndryshon Rregulloren (KEE) dhe shfuqizon Direktivat 64/221/KEE, 68/360/KEE, 72/194/KEE, 73/148/KEE, 75/34/KEE, 75/35/KEE, 90/364/KEE, 90/365/KEE dhe 93/96/KEE, botuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian L 158/77.</td><td colspan="5">Legjislacioni shqiptar i propozuar : Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar”<br><br>Shkalla e përafrimit(një nga tre mundësitë e mëposhtme) në total e projekt-aktit<br>Përputhshmëri e plotë<br>Përputhshmëri e pjesshme Po<br>I papërputhur</td></tr>
<tr><td>1</td><td>2</td><td>3</td><td>4</td><td>5</td><td>6</td><td>7</td></tr>
<tr><td>Neni</td><td>Teksti</td><td>Referenca</td><td>Neni</td><td>Teksti</td><td>Përputhsh mëria</td><td>Shënime</td></tr>
<tr><td>Në këtë kolonë shënohet vetëm numri i nenit të instrumentit të acquis së BE-së që</td><td>Në këtë kolonë shënohet teksti i nenit që i korrespondon numri në kolonën e parë. Sipas rastit, çdo nen mund të copëzohet në paragrafë apo nënparagrafë, duke vendosur secilin në një rresht të veçantë.</td><td>Në rastin kur projektaktet që përafrohen janë më shumë se një, atëherë ato numërtohen</td><td>Në këtë kolonë shënohet numri i nenit të projekaktit</td><td>Në këtë kolonë shënohet teksti i nenit, ose i pjesëve të nenit, që i korrespondon numri në kolonën e katërt dhe që ka përafruar kërkesat e nenit të acquis së BE-së në kolonën e dytë.</td><td>Në këtë kolonë shënohet shkalla e përafrimit për çdo nen të veçantë.</td><td>Në këtë kolonë jepen shënime në lidhje me shkallën e përafrimit. Kur përafrimi nuk është i plotë, jepen arsyet dhe afatet se kur do të bëhet</td></tr>
</table>

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Neni 24, pika 1 | 1.Subjekt i këtyre dispozitave specifike siç parashikohen në Traktat dhe në legjislacionin dytësor, janë të gjithë shtetasit e Bashkimit që qëndrojnë në bazë të kësaj direktive në territorin e Shtetit Anëtar pritës të cilët do të gëzojnë trajtim të barabartë me shtetasit e këtij Shteti Anëtar brenda objektit të Traktatit. Nga kjo e drejtë përfitojnë edhe anëtarët e familjes së tyre të cilët nuk janë shtetas të Shtetit Anëtar dhe kanë të drejtën e qëndrimit ose qëndrimit të përhershëm. | | Neni 5, i projektligjit | Në nenin 72, në shkronjën "a", pas fjalëve "shtetas të një prej vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe zonës Shengen", shtohen fjalët "dhe anëtarët e familjes së shtetasve të një prej vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe zonës Shengen," | Përafrim i pjesshëm | Nëpërmjet këtij paragrafi rritet masa e përafrimit, por sërisht ai mbetet i pjesshëm sepse i referohet vetëm të drejtës në fushën e punësimit dhe vetëpunësimit të anëtarëve të familjeve të shtetasve të Bashkimit Evropian |